

**STATUTI DHE AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "AS DOMAIN AL" SH.P.K.**

Sot më datë 23.09.2024 , themelohet shoqëria tregtare "AS DOMAIN AL" sh.p.k

Anëtarët themelues

1. **Z. Ferdinand Lamaj**, biri i Kujtim dhe Naxhije, shtetas shqiptar, i datëlindjes 04.05.1962, lindur në Tiranë dhe banues në Lyon, Francë, identifikuar me numër identifikimi personal 6900026932, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar
2. **Z. Kristi Lamaj** i biri i Arben dhe Ledia, shtetas shqiptar, i datëlindjes 01.11.1999 lindur dhe banues në Tiranë, identifikuar me numër identifikimi J9110106J, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar
3. **Z. Eduart Koruni**, i biri i Thimit dhe Valentina, shtetas shqiptar, i datëlindjes 01.09.1960, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, identifikuar me numër identifikimi G00901179E, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar




Të tre së bashku me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, të shprehur nëpërmjett këtij Akt Themelimi dhe Statuti, ranë dakord për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "AS DOMAIN AL" sh.p.k" me kushtet e mëposhtme.

**KREU I  
EMRI I SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI**

**NENI 1  
EMRI I SHOQËRISË**

Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar do të jetë "AS DOMAIN AL".

**NENI 2  
SELIA**





Adresa ku do të ketë selinë do të jetë: " Rruga: "Sitki Çiço, Ndërtesa 6, apartamenti 5," Tiranë.( e cila do te jete një objekt I marrë me qera)  
Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose të mbyllë degë ose zyra përfaqësimi , Brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

### NENI 3 KOHËZGJATJA

Kjo shoqëri do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore pa afat të përcaktuar.




### NENI 4 OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

4.1. Kjo shoqëri ka në destinacionin e saj si objekt: Krijimin e Platformave për shërbime online. Platforma për regjistrimin e emrave të domain-it në zonën .AL. Tregtim online, softwares/hardwares, data center cryptomonedhes. Ndërtimin e faqeve në web. Krijimi i programeve të të gjitha llojeve të teknikës profesionale duke përdorur të gjitha teknikat bashkëkohore dhe moderne të avancuara. Zhvillim i softwer inovativ, sistemet e menaxhimit në web, projektim dhe konsultim për krijimin e pajisjeve hardware, software dhe aplikacione web inovative. Menaxhimin e faqeve të internetit, revistave, gazetave me qëllim promovimin dhe shpërndarjen e kulturës, fushata innovative marketing. Përdorimi i mjeteve teknologjike të avancuara dhe inovative. Zhvillimi i produkteve, shërbimeve në lidhje me aktivitetet IT bazuar në kriptografi dhe teknologji "blockchain", blerjen dhe përdorimin e Buletini përfaqësimeve numerike të vlerës , të përdorura në baza vullnetare , si një mjet për shkëmbim për blerjen e të mirave dhe shërbimeve (monedhat virtuale) . Krijimi i dyqanet online, ndërtimi i faqeve të internetit, aplikacione online ose Media për në web, zhvillimin e teknologjive të reja. Gjithashtu ofrimin e mundësive për reklamim në faqet e kërkimit ose portalet (Search Engines) Google, Yahoo, Bing etj, krijimin e strategjive të marketingut , menaxhimi i faqeve dhe nënfaqeve online.

Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie do të zhvillohet brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, aktivitete që një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi.

#### 4.2. Për përmbushjen e objektit sa më sipër shoqëria

a) Mundet që të kryejë aktivitetin e saj, por edhe të marrë pjesë në trajnime, organizime si dhe lobime në shoqëri sipërmarrëse të të njëjtit fokus, apo në cdo strukturë ose konjunkturë përbashkuese, që çon përpara apo udhëheq grupet e interesit në përgjithësi në lidhje me këtë objekt.





b) Shoqëria mundet të lidhë kontrata shitblerje, përdorimi, menaxhimi , sipërmarrje në lidhje me fushën ku ka dhe fokusin e saj me biznese, televizione, institucione shtetërore apo private të çdo lloj fushe më qëllim dhënien e shërbimit në fushën që vetë shoqëria ofron.

c) Shoqëria në kuadër të zgjerimit të saj mund të bëjë kurse trajnimi për të tretët, ose mund të jetë vazhdimisht në trajnime edhe vetë, për shkak të avancimeve të kohës në fushën e teknologjisë, me shkak përmirësimin dhe përditësimin me risitë në këtë fokus.

c) Shoqëria mund të veprojë brenda dhe jashtë shtetit Shqiptar, dhe të kryejë çdo veprimtari dhe shërbim në lidhje me objektin e veprimtarisë që ka në fokus.

## KREU II

### KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

#### NENI 5




#### KAPITALI I SHOQËRISË

5.1. Kapitali fillestar i shoqërisë është 300.000 lekë i ndarë në tre kuota. Kapitali i shoqërisë nënshkruhet menjëherë nga të gjithë ortakët dhe do të paguhet nga ata që e zotërojnë 100%, sipas pjesëve takuese dhe konkretisht”

1. **Z. Ferdinand Lamaj**, i biri i Kujtim dhe Naxhije, shtetas shqiptar, i datëlindjes 04.05.1962, lindur në Tiranë dhe banues në Lyon, Francë, identifikuar me numër identifikimi personal 6900026932 , madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili zotëron 80% të kapitalit.
2. **Z. Kristi Lamaj** i biri i Arben dhe Ledia , shtetas shqiptar, i datëlindjes 01.11.1999 lindur dhe banues në Tiranë, identifikuar me numër identifikimi J9110106J, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili zotëron 15% të kapitalit.
3. **Z. Eduart Koruni**, i biri i Thimit dhe Valentina, shtetas shqiptar, i datëlindjes 01.09.1960, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, identifikuar me numër identifikimi G00901179E, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili zotëron 5% të kapitalit.

5.2. Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e shoqërisë.

#### NENI 6





## KALIMI I KUOTAVE

Në rast se një ortak apo një bashkëzotërues i një kuote dëshiron të bëjë kalimin e kuotave me një nga mënyrat e parashikuara nga Ligji "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", më parë duhet të marrë miratimin nga ortakët e tjerë dhe të drejtojë kërkesë me shkrim.

Në momentin që një prej ortakëve ka ndërmend të kalojë kuotën e tij, si fillim duhet t'ia bëjë me dije ortakëve të tjerë, në mënyrë që këta të fundit të ushtrojnë të drejtën e parablerjes së kuotës.

## NENI 7

### ZMADHIMI I KAPTALIT

Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë me votat pro të  $\frac{3}{4}$  të ortakëve pjesëmarrës apo të përfaqësuar që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të Shoqërisë.

Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakut që është thirrur por nuk ishte të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që vendosi për zmadhimin e kapitalit. Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë, në përpjestim të drejtë me kuotat që zotërojnë në Shoqëri. Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të pjesës së tyre, kapitali i panëshkruar mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë sërish të drejtën për nënshkrimin e kapitalit, në përpjesëtim të drejtë me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

## NENI 8

### ZVOGËLIMI I KAPTALIT

Asambleja e Përgjithshme mund ta zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, votat pro të  $\frac{3}{4}$  të ortakëve pjesëmarrës apo të përfaqësuar që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të Shoqërisë. Në çdo rast, kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e përcaktuar me ligj. Ortakët e përballojnë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

## KREU III

### ORTAKËRIA

## NENI 9



Ortakët e shoqërisë tregtare "AS DOMAIN AL" shpk, gëzojnë të gjitha të drejtat dhe marrin përsipër detyrimet që pasqyrohen në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, në Aktin e Themelimit dhe në Statutin e Shoqërisë.

#### NENI 10

#### TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE

1. Të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve duke ushtruar të drejtën e votës së tyre
2. Të paraqesin pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë ndaj administratorit.
3. Të informohen mbi përmbajtjen e raportit të administrimit, inventarët e llogaritë vjetore, tekstet e vendimeve të propozuara, dhe raportin e ekspertit kontabël:
4. Të përfitojnë nga fitimi i shoqërisë.
5. Të kërkojnë prishjen e shoqërisë në rrethana të caktuara.

#### KREU IV

#### ORGANET E SHOQËRISË DHE KOMPETENCAT E TYRE

#### NENI 11

#### ASAMBLEJA E ORTAKËVE




1. Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë.
2. Ortakët mund t'i delegojnë kompetencat e tyre me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
3. Çdo klauzolë e kundërt është e pavlefshme në këtë rast.

#### NENI 12

#### KOMPETENCAT E ASAMBLESË

Asambleja e Ortakëve ka të drejtë:

1. Të hartojë e miratojë ndryshimet në Statut dhe Aktin e Themelimit;
2. Të miratojë bilancin vjetor të shoqërisë
3. Të vendosë për zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
4. Të emërojë dhe shkarkojë administratorin e shoqërisë;








4. Të shpallë prishjen, likuidimin dhe falimentimin e shoqërisë;
5. Të shprehet për kohëzgjatjen e shoqërisë;
6. Të miratojë marrëveshjet e arritura në qarkullimin civil të saj;
7. Të miratojë strukturat e shoqërisë etj.;
8. Çdo vendim tjetër që i njihet nga ligji, Akti i Themelimit të shoqërisë dhe Statutit të saj.
9. Procesverbalet e mbledhjeve ruhen në selinë e shoqërisë.

### NENI 13

#### ADMINISTRATORI DHE KOMPETENCAT E TIJ

Administratori ka këto të drejta:

1. Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhëniet e saj me të tretët, si dhe në administratën publike;
2. Të emërojë pranë shoqërisë personelin e domosdoshëm që i nevojitet asaj në përmbushjen e aktivitetit tregtar dhe ekonomik;
3. Të paraqesë për miratim në Asamblenë e Ortakëve strukturën e brendshme organizative të shoqërisë me emra përkatës dhe të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni i punës i Republikës së Shqipërisë;
4. Të administrojë pasurinë dhe mjetet financiare të shoqërisë brenda kufijve të caktuara nga Asambleja e Ortakëve;
5. Të testojë aftësitë e punonjësve në administratë;
6. Të thërrasë Asambletë e Ortakëve dhe të propozojë çështjet që duhen analizuar, kontratat e bashkëpunimit, rritjen apo zvogëlimin e kapitalit;
7. Të hartojë objektivat e shoqërisë për çdo vit pasues dhe të vendosë e të ndjekë realizimin e detyrave të lëna nga Vendimet e marra nga Ortakët;
8. Të propozojë në lidhje me krijimin apo menaxhimin e aseteve të kompanisë
9. Të hartojë planet e llogarive ekonomike dhe t'i paraqesë ato për miratim tek Asambleja e Ortakëve.





#### NENI 14

1. Administratori është përgjegjës individualisht sipas rastit ndaj vetë shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

#### NENI 15

1. Shoqëria organizon kontrollin e brendshëm me ekonomist të licencuar dhe kur kërkohet nga ligji me një ekspert kontabël të autorizuar, të cilët janë përgjegjës për problemet që mund të shkaktojnë nga moskryerja në rregull e detyrës së tyre.
2. Për emërimin, kompetencat, detyrimet, përgjegjësitë, zëvendësueshmërinë, tërheqjen, shkarkimin dhe Shpërblimin e tij zbatohet legjislacioni Shqiptar në fuqi.

#### NENI 16




1. Të gjithë personat që do të punësohen pranë kësaj shoqërie, punësimi i tyre do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale apo kolektive, sipas rastit, në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të secilës palë si dhe paga mujore në perputhje me legjislacionin shqiptar në këtë fushë.
2. Marrja në punë bëhet me rregjistrimin nga punëdhënësi në Librin e Punës së Shoqërisë, si dhe duke njoftuar organet e Punës së Juridiksionit ku ushtron aktivitetin Shoqëria.
3. Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës, bëhet në bazë të një akti me shkrim të lëshuar nga Administratori. Largimi lidhet me mbarimin e kontratës së punës, lirim për shkak të shkeljeve disiplinore ose me kërkesën e të interesuarit, sipas dispozitave që parashikon dhe Kodi I punës.
4. Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së Shoqërisë, do të zgjidhen me mirëkuptim të palëve, të cilat për këtë qëllim mund të caktojnë nga një përfaqësues me prokurë. Kur mirëkuptimi nuk është i mundur palët i drejtohen një ndërmjetësi ligjor dhe në rast se nuk gjendet zgjidhja i drejtohen Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

#### NENI 17

Administrator në fushën e menaxhimit të biznesit do të jetë Kristi Lamaj.

#### KREU IV SHPËRNDARJA E SHOQËRISË

#### NENI 18





Shpërndarja e shoqërisë mund të vijë në cdo kohë dhe për çfarëdo shkak.

Shoqëria mund të prishet para kohe;

- Me vendim të ortakëve.
- Kur mbaron kohëzgjatja e shoqërisë.
- Me vendim të gjykatës ose për arsye të tjera të parashikuara në statut.
- Pas dy vjetëve të veprimtarisë me bilanc negative (Humbje)

Në rast mbyllje ortakët vendosin mbi mënyrat e likuidimit dhe caktojnë një ose më shumë likuidatorë duke ju përcaktuar dhe detyrat. Në rastin e likuidimit emërtimi i shoqërisë do të shoqërohet nga shënimi "Shoqëri në likuidim".

Mbasi bëhet njoftimi i mbylljes së likuidimit dhe kryen formalitetet e duhura, shoqëria çregjistrohet nga regjistri tregtar i Qendrës Kombëtare e Biznesit.

#### **NENI 19 FORCAT MADHORE**




1. Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi kur ka paaftesi paguese pjesore apo të plotë për kryerjen e detyrimeve të tij kur kjo është si pasojë e rrethanave të forcave madhore që vërtetohen pas nënshkrimit të kontratës dhe ortakët nuk mund ti shmangen me masa të arsyeshme.
2. Ngjarje të forcave madhore janë ato që i shpëtojnë kontrollit të ortakëve.
3. Kur ortakët ndodhen në paaftesi të plotësojnë detyrimet e tij për arsye të forcave madhore, në bazë të kontratës dhe statutit duhet të bëjnë cdo përpjekje që ta kapërcejnë këtë vështirësi.

#### **NENI 20 BAZA LIGJORE**

E gjithë veprimtaria e shoqërisë do të bazohet në ligjin 9901 datë 14.04.2008" Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" I ndryshuar si dhe në gjithë legjislacionin e Republikës së Shqipërisë në fuqi.

#### **NENI 21 RUAJTJA E SEKRETIT**

1. Ortakët detyrohen që të mos nxjerrin tek të tretët të dhëna dhe njoftime sekrete që kanë të bëjnë me veprimtarinë ekonomike të shoqërisë.





2. Ortakët e shoqërisë përcaktojnë llojin e të dhënave dhe informatave që konsiderohen sekrete.

**NENI 22  
DISPOZITA TË FUNDIT**

1. Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet Ligji "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" si dhe legjislacioni Shqiptar në fuqi.
2. Ky Statut hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë në Rregjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Tiranë.
3. Ky Statut përpilohet në 3 (tre) kopje origjinale secili me të njëjtën vlerë ligjore. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

**ORTAKËT**

**FERDINAND LAMAJ**

*Ferdinand Lamaj*  
*Lamaj*

**EDUART KORUNI**

*[Signature]*  
*Eduart Koruni*

**KRISTI LAMAJ**

*Kristi Lamaj*  
*Lamaj*